

VENDIM
Nr. 301, datë 5.7.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
DIBËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 5.7.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Dibër, me shkresat nr. 209 prot., datë 5.5.2022, nr. 217/1 prot., datë 26.5.2022, nr. 275 prot., datë 20.6.2022, për ndryshim të drejtuesit teknik dhe me shkresën me nr. 328 prot., datë 1.7.2022, njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik, ka paraqitur pranë ERRU-së, dokumentacionin përkatës të kërkesës për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Dibër në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Dibër ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 45 814 banorë të Bashkisë Dibër;

b) Drejtuesit ligjor i shoqërisë, z. Bedri Kamberi, është diplomuar për Agronomi, Universiteti Politeknik Korçë në vitin 1991, gjithashtu, zotëron dhe diplomë të nivelit të dytë Biologji-Kimi nga universiteti “Aleksandër Moisiu” Elbasan, në vitin 2010;

c) Drejtues teknik i shoqërisë, znj. Sara Osmani, ka diplomë *Bachelor* në Inxhinieri Ndërtimi, Universiteti Politeknik i Tiranës, në vitin 2021. Nga nëntori 2021, vazhdon studimet Master shkencor në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturiste.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Dibër, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Dibër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Dibër sh.a. me (NUIS J66702738B), në kategoritë:
 - a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Dibër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues ligjor: Bedri Kamberi;
 - b) Drejtuese teknike: Sara Osmani.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Dibër sh.a. është Bashkia Dibër.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Dibër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Dibër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani